

## VENDIM I ORTAKUT TE VETEM

Sot në datën 01.07.2020, u mbledh Asambleja e Ortakut të vetëm të shoqërisë "Emili Holidays" sh.p.k, shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, identifikuar me NIUS L84302802S zyra e regjistruar e secilës ndodhet në adresën: Rruga e Plazhit, pasuria nr.268/3 ZK.1253 Borsh, Bashkia Himarë.

Pasi u verifikua pjesëmarrja e ortakeve, rezultoi se është i pranishëm në mbledhje ortaku i vetëm që përfaqëson 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë.

Bazuar në statutin e shoqërisë dhe Raportin e Vleresimit nga studio vlerësuese "AD&IS" sh.p.k, Ortaku i Vetëm mori vendim përkatësisht me rendin e ditës si më poshtë

Vendosi:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me kontribute në natyrë me pasurinë e llojit tokë pemtore për vlerën 29.802.756 (njëzet e nëntë milion tetëqind e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.
2. Të miratojë rritjen e kapitalit të shoqërisë nga 10.000 (dhjetë mijë) lekë në 29.812.756 (njëzet e nëntë milion tetëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë i ndare perkatesisht në (i) 10.000 (dhjetë mijë) lekë në para dhe (ii) 29.802.756 (njëzet e nëntë milion tetëqind e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë në natyrë të cilat zotërohen 100% nga Z.Jakup Xhelili dhe përfaqësojnë 1 (një) kuotë të shoqërisë.
3. Ngarkohet administratori i shoqërisë "Emili Holidays" sh.p.k Z.Gerond Labi dhe/ose persona të autorizuar prej tij të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e vendimit të mësipërm dhe rregjistrimin e këtij Vendimi në QKB dhe rregjistrimin të pronës në Drejtorinë Vendore të Kadastrës Sarandë .

Vendimi i mesipërm merret nga Asambleja e Ortakut të Vetëm, bazuar në nenet përkatës të Statutit të shoqërisë, si dhe të ligjit nr.9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Për sa më sipër u hartua ky vendim, i cili pasi lexohet, firmoset me vullnet të lirë nga Ortaku i vetëm.

**Ortaku i Vetëm**

**Z. Jakup XHELILI**



## VENDIM I ORTAKUT TE VETEM

### Mbi caktimin e ekspertit Vlerësues

Sot në datën 13.06. 2020, u mbledh Asambleja e Ortakut të vetëm të shoqërisë "Emili Holidays" sh.p.k, shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, identifikuar me NUIS L84302802S zyra e rregjistruar e secilës ndodhet në adresën: rruga e Plazhit, Fshati Borsh, Bashkia Himarë.

Pasi u verifikua pjesëmarrja e ortakëve, rezultoi se është i pranishëm në mbledhje ortaku i vetëm që perfaqeson 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë.

Bazuar në statutin e shoqërisë Ortaku i Vetëm mori vendim përkatësisht me rendin e ditës si më poshtë vendosi:

1. Të miratojë emërimin e shoqërisë vlerësuese "AD&IS" sh.p.k me Liçencë Profesionale Vsh.0437/1 për përgatitjen e Raportit të vlerësimit të pasurisë tokë pemtore nr.pasurie 268/3 ZK.1253 Bashkia Himarë në pronësi të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "Emili Holidays" sh.p.k Z.Gerond Labi dhe/ose persona të autorizuar prej tij të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e vendimit të mësipërm dhe rregjistrimin e këtij Vendimi në QKB .

Vendimi i mësipërm merret nga Asambleja e Ortakut të Vetëm, bazuar në nenet përkatës të Statutit të shoqërisë, si dhe të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Për sa më sipër u hartua ky vendim, i cili pasi lexohet, firmoset me vullnet të lirë nga Ortaku i vetëm.

Ortaku i Vetëm

Z. Jakup XHELILI

